

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ARTUR KALAJA

11/08/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 06.11.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Kalaja, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 08.11.2019, vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Artur Kalaja, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Pamela Qirko, znj. Alma Faskaj relatore, znj. Firdes Shuli anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.